



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2253 prot.

Fushë-Arrëz, më 30.07.2025

PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren përfundimtare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 30.07.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Afrim Ndoj; Besjana Marku; Franc Doda; Lezina Ceca; Valentina Lleshaj; Vjollca Tabakaj; Zef Cara.**

(8 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë Kryetari i Bashkisë, **Z. Hil Curri; Çun Vata** përfaqësues i policisë në zonën e Njësisë Administrative Fierzë; **Gjok Gjergj Faslia**, i cili ka drejtuar një kërkesë Këshillit Bashkiak; **Çun Vata**, punonjës policie pranë Njësisë Administrative Fierzë.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur përfundimtare e mbledhjeve, dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulan secili prej tyre, sipas agjendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përvetësimi! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak përfundimtare e mbledhjeve, që janë thirrur përfundimtare e mbledhjeve, që mbulan secili prej tyre, sipas agjendës ditore. Në vijim tē njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarjen (8 Këshilltarë) e cila plotëson kushtet përfundimtare e mbledhjeve.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Parashtronhet rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.07.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.06.2025.
3. Projektvendim përmiratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % përfundimtare e mbledhjeve, që janë thirrur përfundimtare e mbledhjeve, që mbulan secili prej tyre, sipas agjendës ditore.
4. Projektvendim përmiratimin e tavaneve përfundimtare të buxhetit afatmesëm 2026-2028.
5. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
6. Të ndryshme.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.07.2025.

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës sipas Njoftimit:

- Miratohet rendi i ditës me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.06.2025.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak:

Lexohet procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 26.06.2025.

Besjana Marku, anëtare e Këshillit Bashkiak, nuk dakordësohet me një lapsus në interpretimin e miratimit të një projektvendimi i cili është theksuar në Shënimin 3 ku thuhej: "Kishte një lapsus fillimisht në interpretimin e miratimit të këtij projektvendimi por bazuar në Nenin 54 dhe Nenin 55 të ligjit 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, qartësohemi se 9 vota pro imjaftojnë që ky projektvendim të miratohet".

Ndërkohe ndërhy Afrim Ndoj, anëtar i këshillit dhe kërkon të mos lexohet procesverbali sepse e kemi parë dhe lexuar, është në dosjet tona.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Shpjegon Këshilltarët se ky është rast i veçantë që lexohet procesverbali. Prosesverbali është detyrim ligjor, bëhet transparent në faqën zyrtare, një kopje shkon në Prefekturë, një kopje ruhet në dosjen e mbledhjes së Këshillit dhe përmban gjithçka që kemi thënë secili prej nesh. Sa i përket lapsusit në interpretim është shpjeguar në Shënimin 3 të këtij procesverbali. Pra e para, ishte lapsus dhe e dyta nuk mohohet vota e 9 këshilltarëve, gjithashtu nuk mohohet në mënyrën më absolute e drejta e qytetarit kur aplikon dhe këshilltarët e votojnë të ketë miratimin e projektit të tij.

Edhe një shpjegim për ju: Lidhur me shqetësimin e këshilltares Besjana Marku kam drejtuar një shkresë ASHK-së ku i kemi kërkuar sqarimin për shqetësimin që ka ngritur këshilltarja, sapo të vijë përgjigjja do t'ju vihet në dispozicion për tu njojur me të.

Pika numër 3 e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Qershor 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Klotilda Curri, Përgjegjëse e Zyrës së Emigracionit dhe Çështjeve Sociale, shpjegon se për muajin Qershor 2025 kemi propozuar për ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 27 familje, me fond 110,712 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,845,203 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në shumën 110,160 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 12 familje me fond 42,288 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .

3. Njësia Blerim , 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Fierzë , 3 familje me fond 19,424 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .

Për këtë muaj nuk është shtuar asnje familje, ndërsa largohen nga bllok ndihma e 6% familjet që i perkasin Njësisë Qendër:

1. Hase Selmani, për riaplikim në Ndihmë Ekonomike
2. Drande Gjonaj, për riaplikim në Ndihmë Ekonomike
3. Hatmane Cakaj, për riaplikim në Ndihmë Ekonomike

Franc Doda, anëtar i komisionit, i njohur edhe më parë me materialin, shprehet se është dakord me listën emrore të përfituesve të Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Qershor 2025.

Z. Doda thotë se për arsyet e mungesës së fondit janë hequr 3 persona nga lista e mëparshme dhe jemi dakordësuar për disa gjëra dhe kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera. Do ta ndjekim me vëmendje dhe do të shikojmë se personat e propozuar banojnë apo jo aty ku thuhet dhe do t'i përbahemi kriterit të përfitimit përcaktuar më herët me vendim këshilli. Punonjësit e Zyrës së Çeshtjeve Sociale duhet t'i ndjekin nga afër por edhe përmes punonjësve të Njësive Administrative për zbatimin e kritereve të miratuara. Duhet të ndihmohen persona të tjerë që janë në nevojë dhe plotësojnë kriteret.

Franc Doda anëtar i komisionit, thekson në mënyre të përsëritur se duhet të kontrollohen individët atje ku jetojnë dhe si i kanë kushtet në mënyrë që të trajtohen ato familje që janë në nevojë dhe që plotësojnë kriteret e përfitimit.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë:

Ju përshëndes të gjithëve! Rrallëherë ndodh që në këshillat bashkiakë të ketë konsensus në shërbimin ndaj qytetarëve dhe përkthjetë ju përgëzoj si anëtarë këshilli që keni qenë mbështetës në plotësimin e nevojave të qytetarëve me ato mundësi që ka bashkia. Kontrollin mbi territorin e kemi, problematikat janë të njohura përmes administratës por edhe përmes këshilltarëve. Për hir të vërtetë funksionon një sistem i apikimit për ndihmë ekonomike i cili nuk jep shpjegim apo arsy se pse njëri fiton dhe tjetri jo dhe ajo që thuhet në raste të caktuara është se nuk përfiton personi apo del nga sistemi për pikë të pamjaftueshme.

Ne nuk mund të mohojmë të drejtën e banorëve që janë të pashaportizuar këtu dhe që nga verifikimet banojnë po këtu. Unë edhe vetë personalisht jam angazhuar të kemi përfitues që plotësojnë të gjitha kriteret.

Afrim Ndoj, anëtar i këshillit:

Ne do të shqyrtojmë vetëm bllok-ndihmën ekonomike prej 6% që na takon ne si këshill nuk do të merremi me sistemin dhe me atë që nuk na përket ne.

Klotilda Curri, Përgjegjëse e Zyrës së Emigracionit dhe Çeshtjeve Sociale në Bashki, shpjegon se nuk shtohet në bllok-ndihmën e 6%asnje familje apo individ për muajin Qershor 2025.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Zyra e Emigracionit dhe Çështjeve Sociale duhet të jetë e përditësuar me çdo ndryshim dhe të njoftojë komisionin përkatës.

Sa më shumë aplikime aq më mirë do të ishte në mënyrë që të përfitojnë të gjithë familjet në nevojë dhe që plotësojnë kriteret.

Meqenëse Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Qershori 2025 përmes votimit:

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Qershori 2025 me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 4 e rendit të ditës: Projektvendim për miratimin e tavaneve përfundimtare të buxhetit afatmesëm 2026-2028.

Dritan Lika, Drejtor i Zyrës së Financës:

Përshëndetje të gjithëve! Atëherë lidhur me projektin mbi Tavanet përfundimtare të buxhetit afatmesëm 2026-2028 :

Tavanet përfundimtare të buxhetit Afatmesëm 2026-2028 nuk kanë asnjë ndryshim me Tavanet përgatitore, prandaj në këtë pikëpamje nuk ka nevojë për shumë shpjegime se të njëjtin projekt pa asnjë ndryshim e kemi bërë më herët i cili wshtw prezantuar para jush me tw gjitha detajet.

Meqenëse nuk ka diskutime ftoj këshilltarët të miratojmë me votë projektvendim për miratimin e Tavaneve përfundimtare të buxhetit afatmesëm 2026-2028:

➤ **7 vota pro**

1 vota kundër

0 vota abstenim

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Nuk miratohet projektvendimi për miratimin e tavaneve përfundimtare të buxhetit afatmesëm 2026-2028.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit të Bashkisë: Vota kundër është e këshilltarit Afrim Ndovë me argumentin se nuk është i gatshëm dhe nuk dëshiron aktualisht të votojë PRO.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 5 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Gjokë Gjergj Faslia ka paraqitur një kërkesë pranë sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe sot e kemi present në mesin tonë. Bëhet fjalë për mungesë të ujit të pijshëm të personit në fjalë.

Gjokë Gjergj Faslia, banorë i fshatit Porav të Njësisë Administrative Fierzë, njëkohësisht Kryetar i fshatit Porav:

Unë kam një problem me një komshi për ujin e pijshëm e njëkohësisht edhe për ujin e vaditjes. Gjithmonë kemi pasë 6 herë radhë nga ai ujë, ato komshinjtë kanë pasë 2 herë radhë. Ata pretendojnë se uji del në vendin e tyre. Na kanë prerë tubat e ujit disa herë mua dhe të gjithë

vëllezërve të mi dhe ka mbi dy muaj që kam mungesë të ujit të pijshëm. Jam 75 vjeç me tre fëmijë jetim, me bashkëshorten të pamundur fizikisht duke përjetuar këto ditë të nxehta shumë me vështirësi dhe duke kërkuar burime uji shumë larg për të mbushur bidona dhe shishe me ujë pasi më kanë prerë linjën e ujit. Mosmarrëveshjen e kemi me Gjelosh Ismailin dhe Kreshnik Ismailin.

Disa herë më kane prerë tubin e ujit pasi e kam vërtetuar kush e ka bërë kam ndërrmarrë të njëtat hapa edhe unë dhe iu kam prerë ujin atyre njëherë të vetme dhe për këte arsyë jam shoqëruar në komisariat nga policia ndërkohe qe atyre nuk u është ndërmarr asnjë masë por iu është lidhur sërisht tubacioni i ujit në burim dhe mua jo dhe me kishin marr krejt linjën e ujit që e kam blerë. Këte burim uji e kemi nder breza pjese tonën dhe duan ta privatizojnë duke u justifikuar që është në tokën e tyre. Ka qenë Kryetari Bashkisë vetë i katërti atje nw Porav dhe unë kam thënë do të dakordësohem për një zgjidhje por pala tjetër nuk kanë qenë dakord. Unë i jam drejtar Këshillit të bashkisë për të marrë një mendim për zgjidhjen me drejtësi të këtij konflikti si për mua si për palën kundërshtare, veç të kemi ujë të pijshëm. Unë përsëri jam dakord për me gjetë një zgjidhje të përbashkët për ujin e pijshëm.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Së pari unë si Kryetar Këshilli dua të them se e drejta për të pasur ujë të pijshëm nuk mund t'i hiqet kujt në mënyrë kategorike. Së dyti, e drejta zakonore e trashëguar brez pas brezi nuk mund të mohohet. Tokën e kemi siç na e kanë lënë të parët tanë, kështu që prona trashëgohet sikurse dhe furnizimi me ujë. Realisht shërbimi për ujin e pijshëm te ne është kompetencë e ShA Shkodër. Por edhe ne si Bashki kemi të drejtën të ndërhyjmë lidhur me zgjidhjen e problematikave të tilla. Unë ftoj këshilltarët të jadin mendimin e tyre për rastin në fjalë.

Ne si këshill dhe si Bashki kërkojmë nga ana juaj Gjokë të dakordësoheni mes njëri tjetrin duke rritur mundësinë e bashkëjetesës mes njëri tjetrit, Bashkia sjell tubat dhe materialet e nevojshme. Zgjidhni ju lutem problemet që keni me drejtësinë dhe ne jemi të gatshëm të ju ndihmojmë.

Çun Vata, Punonjës Policie pranë Njësisë Administrative Fierzë:

Kam 6 muaj që punoj punonjës policie pranë Njësisë Administrative Fierzë. Ky konflikt është i mbartur prej 1.5 deri në 2 vjet më parë. Atje është një burim uji i pijshëm që quhet burimi i Kishës dhe është përdorë edhe për vadirje në sezonin e verës nga të dy palët që janë në konflikt. Bashkia ka shkuar dhe nuk është gjetë një zgjidhje. Secila palë kanë dëmtu tubat njëri tjetrit dhe për këtë palët janë në Prokurori për shkatërrim prone dhe hetimi vazhdon. Tani situata kërkon të arrihet dakordësia mes dy palëve, Gjokë Faslia me vëllezërit dhe Kreshnik Ismaili me vëllezërit për të marrë ujin e pijshëm. Ai burim është pronë e shtetit.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë:

Gjithçka nevojitet është palët të dakordësohen me një zgjidhje dhe ne si bashki jemi të gatshëm të dërgojmë tubat dhe bazën materiale.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Unë propozoj që të ngemë një komision prej tre këshilltarësh i cili do t'i bashkohet komisionit të ngritur më herët nga kryetari i Bashkisë për të njëjtën çeshtje. Komisioni do të shkojë shumë shpejt në vendin e problematikës në Porav, Fierzë dhe do të bashkërendojë punën për stabilizimin e situatës dhe zgjidhjen e problematikës.

Propozojmë përbërjen e komisionit:

1. Afrim Ndoj

2. Franc Doda

3. Bardhok Qafa

Ftoj këshilltarët të votojmë ngritjen e komisionit prej 3 këshilltarëve:

- Miratohet me votë ngritja e komisionit me anëtarë nga Këshilli Bashkiak i përbërë nga, Afrim Ndoj, Franc Doda, Bardhok Qafa, me

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenum

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Pika numër 6 e rendit të ditës: Të ndryshme

Afrim Ndoj, anëtar i Këshillit Bashkiak:

Ka dy vjet që kërkoj riparimin e dërrasave të urës ku unë dhe shumë banorë të tjerë kalojmë në atë urë për të dalë në shtëpi në fshatin Kryezi të Njësisë Administrative Qafë-Mali. Janë 5 lagje që e shfrytëzojnë atë urë dhe përveç këtyre urën e shfrytëzojnë për të kaluar edhe turistët dhe vizitorë të ndryshëm. Mbi të gjitha jemi edhe fshat turistik dhe kërkoj në emër të komunitetit rregullimin e kësaj ure. Së shpejti kemi edhe festën e Kryeziut.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Afrim, në dijeninë time janë blerë dërrasat për riparimin e asaj ure dhe përpos kësaj ka një formë tjetër për një mundësi ku Fondi Shqipëtar i Zhvillimit bën mbështetje me materiale ku ne kemi miratuar një grup punonjësish në gatishmëri të punës në shërbim të komunitetit. Për detaje të mëtejshme kemi këtu Kryetarin e Bashkisë, Z. Hil Curri.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë:

Shqetësimi i Afrimit dhe Besjanës është plotësish i drejtë. Ne e kemi diskutuar edhe më parë këtë problematikë me Afrimin, ura ka pasë një defekt. Ne i kemi siguruar të gjitha materialet për riveshje.

Afrim Ndoj, anëtar i Këshillit Bashkiak: Ajo urë është aset i Bashkisë Fushë-Arrëz dhe duhet të mirëmenagjohet. Pse kanë ndodhur defektet e urës? Duhet edhe ekspertizë për të përcaktuar shkaqet e dëmtimit dhe më pas të veprohet me rregullimin.

Kam kërkuar gjithashtu edhe ndriçimin e asaj zone. Rregullimi i urës është parësore dhe jetësore, ndaj ju lutem merreni seriozisht në mënyrë që të mos kemi ndonjë aksident me pasojë jetën për hir të degradimit të urës. Ju lutem mos të ketë këndvështrim politik kjo situatë.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë: Aty ka pësuar një goditje, arsyet nuk dihen. Sa i përket riparimit, ne kemi riparuar një urë tjetër dhe tanë jemi gati me dërrasa dhe gjithçka për ta rregulluar edhe këtë. Ne po sigurohemi që mbas ndërtimit të mos kemi problematika dhe kjo është arsyaja e vonësës por ju garantoj që para festës së Kryeziut do të ndërhyhet për riparimin e saj. Sa i përket ndriçimit, kemi aplikuar te Fondi Shqipëtar i Zhvillimit dhe kemi marrë deri tanë 100 shtylla, presim të marrim edhe kabullin për lidhje. Sa i përket këndvështrimit politik, shyqyr që kemi këshilltarë nga të gjitha forcat politike që ngrejnë zërin këtu për problematika reale dhe shteti na dëgjon dhe mundet të na japë fondin e duhur për zgjidhjen e problematikave. Ne tashmë jemi gati për ndërhyrje lidhur me riparimin e urës.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

Naze Selimaj
Afëvuan Nësorat
Zef Lleshaj Vlq.
Valentina Lleshaj Vlq.
Vjollca Tabakaj T.

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

